



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Datë: 15.12.2023
02 Nr.115/01-32861/23

PROCESVERBAL

Diskutimi Publik për Draft Planin Lokal të Veprimit për Barazinë
Gjinore 2024-2026

I mbajtur më 13.12.2023, e mërkurë, duke filluar nga ora 11:00
VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash

Konsultimi publik për Draft Planin Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024-2026 ka zgjatur një muaj, sipas kriterëve të përcaktuara ligjore. Njoftimi për nisjen e procesit të konsultimit publik dhe mbajtjen e diskutimit publik, si dhe publikimi i Draftit për konsultim publik, janë publikuar në uebfaqen zyrtare dhe në Facebook-un zyrtar të Komunës.

Njoftimi në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://www.kryeministri.gov.net/dragashit/wp-content/uploads/sites/12/2023/11/Njoftimi-1.pdf>

Boshnjakisht: <https://www.kryeministri.gov.net/dragashit/wp-content/uploads/sites/12/2023/11/Njoftimi-1.ba>

Njoftimi në Facebook-un zyrtar:

Shqip dhe Boshnjakisht:

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=photos3614875412011000&type=share
https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=photos3614875412011000&type=share

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 115/01-32861/23
15.12.2023
Dragash - Dragaš

Diskutimi publik ka filluar në ora 11:00. Hapjen dhe prezantimin e Draftit për Planin Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024-2026 e ka bërë zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Dragashit, znj. Lindita Kozmaqi Piraj.

Lindita Kozmaqi Piraj, zyrtare për Barazi Gjinore: Përshëndetje për të gjithë! Mirë se keni ardhë në këtë diskutim publik për Draftin e PLVBGJ. Ky dokument ka qenë në konsultim publik për një muaj. Hartimi i këtij dokumenti është bërë nga Grupi Punues në bashkëpunim me UN Women, përmes zhvillimit të një sërë takimesh. Gjatë kohës sa ka qenë në konsultim publik, janë përcaktuar edhe kostot buxhetore. Draft dokumenti i PLVBGJ-së është hartuar në të dy gjuhët zyrtare, shqip dhe boshnjakisht. Besojmë se kemi hartuar një Plan të veprimit i cili do të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e pozitës së përgjithshme të gruas në Komunën e Dragashit, përmes aktiviteteve të cilat nxisin dhe promovojnë barazinë gjinore.

Qamil Kolloni, drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim: Përshëndetje për të gjithë! Faleminderit që keni gjet kohë me marrë pjesë në këtë diskutim publik. Bashkë me Zyrën për Barazi Gjinore dhe partnerët e UN Women jemi angazhuar maksimalisht që të kemi një Plan i cili përfshin dhe mbulon një sërë aktiviteteve për barazi gjinore. Si DEFZh do të jemi të përkushtuar që të gjitha implikimet buxhetore që dalin nga ky Plan t'i marrim parasysh gjatë punës sonë, në mënyrë që të bëjmë ndarjet e nevojshme buxhetore për realizimin e aktiviteteve dhe objektivave të këtij Plani.

Liridona Misinaj, Drejtoreshë e DKRS-së: Përshëndetje për të gjithë! Ju përgëzoj për angazhimin të gjithë akterëve që keni marrë pjesë në hartimin e këtij Plani. Mendoj se ne jemi ende pak paragjykses, sa i përket çështjeve gjinore. Si udhëheqëse e DKRS-së dhe si grua që mbaj një pozitë udhëheqëse, mund të them se ka ende sfida dhe vështirësi në këtë drejtim, ndonëse kemi përmirësime. Por, besoj se me punën dhe angazhimin e të gjithëve do të arrijmë që të ngrisim edhe me shumë vetëdijësimin lidhur me barazinë gjinore.

Salmira Usmeni, OJQ "Sensa": Përshëndetje të gjithëve! Ju falënderoj për angazhimin tuaj në hartimin e këtij Plani, i cili ka për qëllim avancimin e pozitës së grave në Komunën tonë dhe rritjen e nivelit të barazisë gjinore. Mendoj që duhet të përqendrohemi më shumë në projektet të cilat nxisin dhe promovojnë punësimin e grave të të gjitha komuniteteve nëpër institucione publike, në arsim, në sektorin privat etj.

Ibrahim Gashi, QPS-Dragash: Ju përgëzoj për punën! Desha të di nëse gjatë kohës sa ka qenë në konsultim publik ky dokument, a ka pasur ndonjë pyetje, vërejtje apo propozim nga ndonjë qytetar, OJQ apo dikush tjetër, që të mund ta diskutojmë ne këtu?

Lindita Kozmaqi Piraj: Edhe pse do të donim të kishim ndonjë pyetje, vërejtje, kritikë apo sugjerim për këtë Plan, fatkeqësisht nuk kemi pasur asnjë e-mail zyrtar nga ndonjë qytetar, OJQ apo ndonjë institucion tjetër.

Ju faleminderit të gjithëve që morët pjesë në këtë diskutim publik! Draft Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore 2024-2026, pas konsultimit publik dhe diskutimit me qytetarët, do të dërgohet për shqyrtim në KPF, për t'u proceduar pastaj edhe në Kuvend Komunal për miratim. Besojmë se në mbledhjen e ardhshme ky Draft do t'u propozohet anëtarëve të Asamblesë si pikë e rendit të ditës për miratim.

Nëse s'ka edhe ndonjë pyetje tjetër, ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe ju dëshiroj një ditë të mbarë!

Diskutimi publik ka përfunduar në ora 12:00!

Linqet e lajmeve për mbajtjen e diskutimit publik, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:

Në uebfaqe:

Shqip: [https://www.komuna.com/faqes/diskutim-public-ni-mirajtimit-veprimit-publik-per-barazine-gjinore-2024-2026](#)

Boshnjakisht: [https://www.komuna.com/faqes/diskutim-public-ni-mirajtimit-veprimit-publik-per-barazine-gjinore-2024-2026](#)

Në Facebook:

Shqip:

[https://www.facebook.com/komunapublike/updates/?id=100066875766996](#)

Boshnjakisht:

[https://www.facebook.com/komunapublike/updates/?id=100066875766996](#)

SHTOJCË: *Lista e pjesëmarrësve në diskutim publik dhe fotografitë*



LISTA E PJESËMARRËSVE NË DISKUTIM PUBLIK
PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE

Datë: 13.12.2023

Vendi: Salla e Asamblesë

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Nr. Telefonit	Nënshkrimi
1.	Dreni Myrtezani	Zyrt. Komunal	3	
2.	VETON HALIZI	SHKUF I KABINETIT		
3.	Vezir Reshiti	Zyrtar		
4.	Selmira Usmani	4vo SENST		
5.	Kenan Krasniqi	Drytoni i DRA		
6.	FITIM KUQTESHI	UDHHEGUES - Z.A.		
7.	IBRAHIM QASHI	DRËKTOR I QPS		
8.	Agon Barhaku	UNICEF		
9.	Samidin Xhelodini	Asambleja		
10.	Kerim Jafiti	K. Dragash		
11.	Faton Napari	ZL. DKA		
12.	ANDRAN BINAKU	UNIONICAN		
13.	FARI KOLLONI	Zyre për Informim		
14.	Anjeta Gheraj	Asambleiste		
15.	LIRIDONA MISINAS	DREJTORESTI		
16.	Damil Kolloni	DREJTOR	2	
17.	Shokron Shkollari	Përklyes		
18.				
19.				
20.				
21.				
22.				
23.				

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragash
02 Nr. Br. 115/01-32864/23
13.12.2023
Dragash - Dragash

